



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 9/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada - Gillogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e Nita Ethemii kandidate për deputete nga subjekti politik Fjala, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 978/2019 të datës 09.09.2019, për tërheqjen nga lista e kandidateve për deputet në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 16.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli Anr.9/2019 i datës 15.09.2019 parashtruar nga kandidatja Nita Ethemii nga Prishtina, lidhur me tërheqjen nga lista e kandidateve për deputet nga subjekti politik Fjala.

II. NDRYSHOHET vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 978/2019 të datës 09.09.2019 dhe **DETYROHET** që kandidaten Nita Ethemii nga Prishtina, ta tërheq nga lista e kandidateve për deputet nga subjekti politik Fjala.

Arsyetim

Me datën 15.09.2019, PZAP-i ka pranuar apelin e dorëzuar nga Nita Ethemii, kandidate për deputete në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik Fjala, me të cilin kërkon që për arsye familjare të tërhiqet nga kandidatura për deputete.

PZAP-i, pas pranimi të apelit në kuptim të nenit 12 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në për apelin që është bërë ndaj vendimit nr. 978/2019 të datës 09.09.2019, të KQZ-së, dhe ka kërkuar përgjigje lidhur me vendimin ndaj të cilit është parashtruar apeli.

KQZ, përmes përgjigjes me shkrim i referohet dhe të njëjtën kohë i citon dispozitat ligjore të LZP-së, sipas interpretimit të së cilave deklaroi se këto dispozita nuk parashohin mundësin e tërheqjes vullnetare të kandidateve nga lista zgjedhore e subjektit politik me të cilin garon, përveç nëse ajo kërkohet me vendim të PZAP-it, kandidati është

pjesë e listës se një subjekti tjetër politik ose ndërron jete, pra ligji nuk lejon KQZ-në, ta tërheq nga lista kandidatin e certifikuar, pasi që KQZ nuk mundet as ta kundërshtoj as t'i vërtetoj arsyet personale të kandidateve, pasi që KQZ mundet vetëm të garantoj për rregullsinë e procesit të aplikimit dhe certifikimit. Si dëshmi ka bashkangjitur: formularin për certifikim të kandidates Nita Ethem, formularin financiar të kandidates në fjalë, shkresat nga ZRPPC-ja për subjektin politik Fjala dhe listën e kandidateve të këtij subjekti.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 09.09.2019 me numër protokoll 978/2019 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ gjeti se:

Apeli është i bazuar

PZAP-i, vlerëson se qëndrimi juridik i KQZ-së, është i pabazuar pasi i njëjti është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në rastin konkret KQZ-ja, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në raport me deklarinimin e kandidatit për tërheqje nga lista e kandidateve për deputet nga radhët e partisë Fjala, meqenëse dispozita të cilës i referohet KQZ-ja, neni 28.1 nuk e sanksionon si ndalesë kandidaten për tërheqje nga lista e kandidateve, nëse kjo bëhet brenda afatit kohor dy ditor para hedhjes së shortit.

Meqenëse e vetmja ndalesë në rastin konkret është tërheqja pas periudhës apo afatit 2 ditor, shkaqet tjera të tërheqjes nuk janë me relevancë as për KQZ-en, e as për PZAP-në, meqenëse është e drejtë e kandidatit se a dëshiron të garoj në zgjedhje apo jo.

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidateve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”, ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidates Nita Ethem, është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar me LZP-në.

Paneli konstaton se apeli është i bazuar pasi që neni 122.1 pika c i LPZ-së, përcakton se: “nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjese në procesin zgjedhor mund të parashtoj apel në PZAP”. Andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh faktin se kandidatja për deputet Nita Ethem, për arsye familjare nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019. Asnjë dispozitë ligjore e LZP-së, nuk e sanksionon të drejtën e tërheqjes së kandidatit nga lista zgjedhore krejt kjo në kuptim të parimit se e drejta për të zgjedh dhe për t'u zgjedh është e drejt individuale e secilit dhe se në asnjë mënyrë nuk paraqet detyrim, përndryshe kjo do të përbënte cenim të drejtave të njeriut.

E drejta për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur është e drejtë dhe jo detyrim i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 45: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Andaj çfarëdo kufizimi apo interpretimi tjetër jashtë këtij domeni dhe jo mbi bazën e rregullimit ligjor nënkupton shkelje të të drejtave të njeriut.

- Me nenin 53 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj.

- Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulojë apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala, dhe PZAP-i, meqenëse e aprovoi të bazuar apelin e kandidates për deputet nga partia Fjala, vendimin e KQZ-së, e ndryshoi dhe vendosi që të njëjtës t’ia lejoi tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputete nga radhët e partisë Fjala.

Andaj në bazë të nenit 122.1 pika c, dhe nenit 118.1, të LPZ-së, neneve: 53 par. 4, 131.4 dhe 131.5 të Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 9/2019 më datën 16.09.2019

Kryesuesi i Panelit
Zyhet Haziri



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LJP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.